REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 1509/1 Prot. Tiranë, më 01.10.2025

**VENDIM**

**Nr. 45, datë 01.10.2025**

**PËR**

**SHPALLJEN E PERIUDHËS SË VETËKANDIDIMIT PËR 1 (NJË) ANËTAR TË KËSHILLIT TË ETIKËS, TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Mbështetur në nenin 44 të ligjit nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 36 të Statutit të Universitetit të Arteve, në Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Etikës të Universitetit të Arteve, miratuar me VSA nr. 23, datë 06.03.2020 si dhe në shkresën nr. 1509 prot., datë 24.09.2025, me lëndë "Përfundimi i mandatit të Anëtarit të Këshillit të Etikës – Studenti Erli LILA" të Kryetarit të Këshillit të Etikës së Universitetit të Arteve,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë fillimin e procedurës së vetëkandimit për 1 (një) anëtar të Këshillit të Etikës, të Universitetit të Arteve, nga kategoria "Student".

2. Periudha e vetëkandidimit do të jetë **nga data 02.10.2025 deri më 09.10.2025** dhe dorëzimi i kërkesës (sipas formatit bashkëngjitur) do bëhet **pranë sekretariatit së Senatit Akademik.**

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi sekretariati i Senatit Akademik dhe një kopje t'i përcillet për njoftim Këshillit të Etikës, drejtuesve të njësive kryesore, si dhe Kryetarit të Këshillit të Studentëve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Dr. Erald Bakalli** **Prof. Najada Hamza**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI I ARTEVE – TIRANË

**Prof. Arben Llozi**

**Prof. Sadik Spahija**

**Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)**

**Prof. Rudina Ciko**

**Prof. Asoc. Dorian Çene**

**Prof. Asoc. Edmond Gjikopulli**

**Prof. Asoc. Genci Fuga**

**Prof. Asoc. Orion Shima**

**Rei Kita (Student FM)**

**Prof. Miltiadh Kutali**

**Prof. Lorenc Radovani**

**Prof. Endri Sina**

**Prof. Gazmend Gjoka**

**Prof. Asoc. Albes Fusha**

**Prof. Asoc. Kristina Laço**

**Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj**

**Enea Trimi (Student FAB)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

Nr.________Prot. Tiranë, më ___/___/2025

**KËRKESË**
**PËR VETËKANDIDIM**

Unë, i/e nënshkruar/i/a_________________________________, **paraqes KËRKESËN**
*(Emër, Atësi, Mbiemër)*
**për vetëkandidim për anëtar të Këshillit të Etikës në Universitetin e Arteve.**

***TË DHËNA TË KANDIDATIT*** *(Plotëso me gërma të mëdha, vendos shenjën X në kuti)*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Emri** | | | | **Vjetërsia në punë (staf ak.)** | | |
| **Mbiemri** | | | | **Nr. personal i letërnjoftimit** | | |
| **Atësia** | | | | **Gjinia** | **M** ☐ | **F** ☐ |
| **Datëlindja** | ____ dita | ____ muaji | ____ viti | **Titulli/Grada (staf. ak.)** | | |
| **Fakulteti** | **FM** ☐ | **FAS** ☐ | **FAB** ☐ | **Pozicioni aktual** | | |

*Shënim: Gjithashtu deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë janë të sakta dhe të vërteta. Jam në dijeni se deklarimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht heqjen e të drejtës për kandidim për këtë pozicion, prandaj, nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se:*

1. Jam student i fakultetit për të cilin kandidoj;
2. Kam notë mesatare mbi 9 (nëntë);
3. Nuk kam masë disiplinore në fuqi.

_______________________________
*(Emër Mbiemër Firmë)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**KËSHILLI I ETIKËS**

Nr. 1509 Prot                                                                                    Tiranë, më 24.09.2025

**Lënda:** Përfundimi i mandatit të Anëtarit të Këshillit të Etikës - Studenti Erli LILA

**KRYETARIT TË SENATIT AKADEMIK**
**UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË**
**Prof. Dr. Erald Bakalli**

Të nderuar,

- Bazuar në Kodin e Etikës së Universitetit të Arteve, Rregullores së Këshillit të Etikës, Statutit të Universitetit të Arteve dhe Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015,
- Bazuar në Strukturën për Vitin Akademik 2024-2025 në Universitetin e Arteve,

Anëtarit të Këshillit të Etikës së Universitetit të Arteve, Erli LILA, në datën 26 shtator i përfundon statusi student, kështu që, sjellim në vëmendjen Tuaj, përzgjedhjen e një anëtari të ri të Këshillit të Etikës, kategoria STUDENT.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**Prof. Pjetër Guralumi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË